



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 01 .

Prishtinë, më 9.10.2017 në ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: kryetari i komisionit- Igor Simić, zëvendëskryetar: Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, anëtarët tjerë: Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Živkovic, Saša Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Sinik dhe Duda Balje.

Nga pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues nga KDI-ja, Artan Murati; konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtpria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i Komisionit - Igor Simić.

Për këtë mbledhje u caktua ky:

Rand i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Mbledhja Konstituive.**

1. Miratimi i rendit të ditës.

Igor Simic – kryetar i Komisionit, anëtar i Listës serbe-LS, me theks të veçantë tha se ndihet i privilegjuar si kryesues i Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe përshëndetë për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit.

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

Kryetari- për prezantim fjalën iu dha anëtarëve të komisionit.

Xhelal Sveçla – zëvendëskryetar i parë i Komisionit, anëtarë i GP Vetëvendosje, për herë të parë deputet në Kuvendin e Kosovës. Ishte i mendimit se do të jetë konstruktiv në funksionalizimin dhe realizimin e detyrave që bartë ky komision.

Danush Ademi – zëvendëskryetar i dytë i Komisionit, anëtarë i GP 6 +, për herë të tretë deputet në Kuvendin e Kosovës, Në mandatin e kaluar ka qen anëtar i komisionit për Komunitete, i cili ka dhënë mendimet dhe sygjerimet e tija konkrete, sa i përket pyetjeve ne funksionin e mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Edhe në këtë mandat, është i gatshëm ti trajtoj shqetësimet e komuniteteve.

Jasmina Zivkovic – anëtare e Listës serbe – LS. Në mandatin e kaluar ka kryesuar këtë komision, në bazë të përvojës diskutoi se Komisioni i përmbahet procedurave të përcaktuara me Kushtetutë dhe Rregulloren e punës së Kuvendit. Nga ky aspekt, Komisioni shqyrton të gjitha projektligjet, harton raporte me rekomandime në kuadër të mbrojtjes së të drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

Saša Milosavljević – anëtarë i Listës serbe – LS. Ai shprehu gatishmërinë në përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi që ka fushëveprimtaria e Komisionit, në mënyrë që angazhimet dhe puna jonë të dal me sukses të duhur.

Duda Balje – anëtare e GP 6+, Është e vetëdijshme për rëndësinë që ka ky Komision, andaj në kuadër të vullnetit të mirë do ti shtyjë përpara çështjet të cilat janë në interes të komuniteteve.

Kujtim Shala - anëtarë i GP-LDK-së, Theksoi se në legjislaturën e kaluar ishte ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në këtë legjislacion është nënkryetar i Kryesisë së Kuvendit dhe anëtar i këtij Komisioni. I dëshiron mbarëvajtje Komisionit dhe shpreh qëndrimin e tij se do të ofroj përkrahje për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.

Albert Kinolli - anëtarë i GP 6+, Si deputet është hera e dytë që marr pjesë në Kuvend. Në fjalën e tij tha se do të ofrojë maksimumin lidhur me çështjet të cilat kërkohet të trajtohen problematikat e komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Rasim Selamanaj - anëtarë i GP – AAK-së, shpreh qëndrimin e tij se do të ofrojë kontribut të duhur, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Fadil Beka - anëtarë i GP-PDK-së. I dëshiron mbarëvajtje Komisionit dhe shpreh qëndrimin e tij se do të përkrahë procedurat të cilat ndërlidhen në interes të komuniteteve.

Mufera Srbica Shinik – anëtare e GP 6 +, Është legjislacioni i pestë si deputete e Kuvendit të Kosovës, dhe e njeh mirë natyrën e punës së Komisionit, gjithnjë duke u bazuar në fushëveprimtarinë e saj. Gjatë këtij mandati, do të angazhohet për ngritjen e problematikave që përfshihen interesat e të gjitha komuniteteve.

2. Mbledhja Konstitutive.

Kryetari - theksoi se Komisioni për të Drejtat dhe Intresat e Komuniteteve dhe Kthim, është komision i përhershëm. në kuadër të fushëveprimit të tij të punës dhe përgjegjësi që i ka, shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Ai, shpalosi në detaje kompetencat e komisionit, të bazuara në Kushtetutë, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës. Sipas fushë veprimtarisë së saj, Komisioni shqyrton projektligjet nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve. E drejta e anëtarëve të tij për të vendosur me shumicën e votave në lidhje me projektligjet, me qëllim të adresimit të drejtë dhe me përgjegjësi të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Një deklaram i tillë duhet dërguar komisionit përkatës funksional të Kuvendit, ose Kuvendit, sipas rastit.

Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorsit përkatës dhe i rekomandon komisionit për Financa dhe Buxhet shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend. Mbikqyrja e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i tij; Dhe çështjet tjera të cilat me vendim të Krysisë i barten këtij komisioni.

Komisioni, veprimtarinë do ta ushtrojë duke u mbështetur në Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2017. Njëherit kryesuesi, propozoi që në mbledhjen e radhës, komisioni të hartojë Planin e punës, për tremujorin e vitit 2017.

Anëtarët e komisionit, folën lidhur me përcaktimin e ditës së mbajtjeve të mbledhjeve të rregullta të komisionit, dhe pas diskutimeve u muar qëndrim që kjo temë të vendoset në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetar i Komisionit

Igor Simić